

AUDITIMI I PERFORMANCËS NË “90 VJET KLSH”

nga Alfred ZYLFI – Auditues i Lartë,

botuar në gazetën “Telegraf”, më 27 prill 2015.

Në hyrje të fjalës përshëndetëse me rastin e 90 vjetorit të krijimit të KLSH-së Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zoti Bujar Leskaj ndërmjet të tjerave u shpreh: **“...cila është hera e fundit që kemi bërë një gjë për herë të parë...”**, e cila përkon me:

- **Hera e parë** që kremtohet një përvjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga momenti i krijimit të tij pas 90 vitesh;
- **Hera e parë** që në vitin 2012 u krijua dhe u formua institucionalisht Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH;
- **Hera e parë** që Auditimi i Performancës me iniciativën e Kryetarit të KLSH-së zotit Bujar Leskaj u pranua, konsolidua dhe u sanksionua ligjërisht nga ligjvënësi si auditim në ligjit 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- **Hera e parë** në ligjin e veprimtarisë së KLSH **përkufizohet** “Auditimi i performancës” i cili ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe përfshin:

- a) auditimin e ekonomicitetit, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cënuar cilësinë e tij;
- b) auditimin e eficiencës, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikat më të mira;
- c) auditimin e efektivitetit, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.
- **Hera e parë** në ligjin e veprimtarisë së KLSH ka një nen të veçantë për auditimin e performancës:

Neni 13 Auditimi i performancës

1. Në auditimet e performancës, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vlerësojë nëse programet, organizimi i punës dhe proceseve, veprimtaritë dhe sistemet e menaxhimit të subjekteve të sektorit publik operojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit është i autorizuar të kryejë auditimin e performancës në çdo moment që e konsideron të nevojshëm.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit publikon raportet e tij mbi auditimin e performancës.

- **Hera e parë** që për Auditimin e Performancës është botuar Udhëzuesi i tij:

...përmbajtja e tij është guri i parë i themelit në ngrehinën e re të auditimit të performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ai përcakton strukturën që udhëheq konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e auditimit të performancës. Qëllimi i tij është:

- Të asistojë audituesit në arritjen e një cilësie maksimale në kryerjen e auditimeve të performancës;
- Të stimulojë kompetencën profesionale të auditueseve këtu në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Të ofrojë një bazë për kryerjen me sukses të këtyre llojeve të auditimeve;
- T'i mundësojë publikut të gjerë dhe përdoruesve specifikë përfitim të një perspektive dhe kuptimi më të mirë të praktikave dhe profesionalizmit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- **Hera e parë** që për Auditimin e Performancës është botuar Manuali i tij:

...Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës është dokumenti i dytë strategjik i departamentit pas Udhëzuesit të INTOSAI-t botuar në Dhjetor 2012 dhe i treti në rrafsh institucional, pas Planit Strategjik të KLSH-së, publikuar në Korrik 2013. Gjenerimi i këtij suporti empirik reflekton disa aspekte strategjike dhe konkretisht:

1. Vizionin dhe filozofinë e strukturave drejtuese për një KLSH moderne, bashkëkohore, shkencore, këshilluese, aktive në jetën sociale, ekonomike e mediatike të Shqipërisë.

2. Rolin dhe rëndësinë që auditimi i performancës ka në konsolidimin e këtij vizioni, të dokumentuara tashmë në Planin Strategjik Institucional 2013-2017, të projektuara me mençuri e largpamësi në Ligjin e ri për KLSH-në, nr. 154/2014, dt. 27.11.2014, dhe të nxjerra në pah e të theksuara vazhdimisht në marrëdhëniet me palët vendase dhe të huaja të interesit.

3. Eksperiencën tashmë mbi 2-vjeçare të audituesve tanë në këtë lloj auditimi, si edhe trajnimet e workshop-et e shumta në të cilat ata kanë marrë pjesë.

4. Rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të këtij lloj auditimi, për të akumuluar dije e njohuri, asistuar agjencitë publike, rritur vlerën e parave të taksapaguesve dhe ndihmuar Kuvendin për një vendim-marrje të shëndetshme dhe transparente.

Ky manual i shërben jo vetëm audituesve të Departamentit të Performancës, por të gjithë kolegëve tanë të departamenteve apo drejtorive të tjera, të cilët kryejnë, kontrollojnë, trajnojnë, rekrutojnë apo thjesht iu pëlqen të studiojnë mbi performancën brenda kuadrit tonë ligjor e rregullator. Në një kohë të dytë, kur auditimi i performancës të urbanizohet si koncept në administratën publike, manuali mund t'iu shërbejë edhe strukturave të auditimit të

brendshëm që vendosin të angazhohen në këtë fushë sfiduese dhe realisht frytdhënëse..... (**B. LESKAJ & R. MUÇA**)

- **Hera e parë** që për Auditimin e Performancës janë botuar Indikatorët e tij:

...Ky udhëzues starton me përkufizimin e fokusit të funksionit të komunikimit dhe vijon me identifikimin e kërkesave për një funksion komunikimi modern dhe vlerë-shtues, të cilin indikatorët matës synojnë ta parametrizojnë për t'ia bërë më lehtë organizatës arritjen e tij. Indikatorët synojnë të jenë mjaftueshëm të plotë, në mënyrë që të mund të aplikohen për të gjithë spektrin e administratës publike; organizatat duhet të identifikojnë ato pjesë të fokusit që aplikohen brenda tyre, pra nëse ato disponojnë të gjitha buxhetet: operative, administrative, për projekte specifike, etj., apo vetëm një apo dy prej tyre...

- **Hera e parë** që KLSH ka organizuar **workshop** dhe atë në Auditimin e Performancës.



- **Hera e parë** që tre botimet **UDHËZUESI, MANUALI dhe INDIKATORË** të **Auditimit të Performancës** u paraqitën dhe u shpërndanë në sallën plenare të Kuvendit të Shqipërisë me rastin e festimeve të 90 vjetorit të krijimit të KLSH-së ndërmjet dhjetëra botime të tjera po të KLSH-së, pjesa më e madhe e të cilave janë botuar tre vitet e fundit.

